

Informata  
mbi përjashtimin nga banesa  
në rastet e dhunës shtëpiake



Baden-Württemberg

MINISTRIA PËR ÇËSHTJE SOCIALE DHE PËR INTEGRIM

Njoftim mbi shpërndarësin:

Kjo fletushkë informuese botohet nga Qeveria e Republikës Baden-Württemberg në kuadër të detyrimit të saj kushtetutar për informimin e qytetarëve. Ajo nuk guxon të përdoret as nga partitë e as nga kandidatet dhe kandidatët ose ndihmëset dhe ndihmësit e tyre gjatë një fushate zgjedhore për qëllim të reklamës zgjedhore. Kjo vlen për të gjitha zgjedhjet.

Keqpërdorim të saj paraqet posaçërisht shpërndarja në manifestime zgjedhore, në tezat informuese të partive si dhe futja, shtypja dhe ngjitja e informacioneve partiake ose reklamave.

Po ashtu ndalohet dhënia e tyre personave të tretë me qëllime të reklamës zgjedhore. Edhe pa ndonjë lidhje kohore me zgjedhjet e ardhshme, fletushka nuk guxon të përdoret asisoj që do mund të kuptohej si anim i botuesit në dobi të grupeve të veçanta politike. Këto kufizime vlejné pavarësisht nga rruga shpërndarëse, d.m.th. pavarësisht nga ajo se në cilën rrugë dhe në cilin numër i është dorëzuar kjo fletushkë pranuesit të saj.

Mirëpo, partive u lejohej që ta përdorin këtë fletushkë për informimin e anëtarëve të tyre.

Botuar nga

Ministria për Çështje Sociale dhe për Integrim

Baden-Württemberg

Schellingstraße 15

70174 Stuttgart

Telefoni: 07 11 123-0

Telefaksi: 07 11 123-39 99

Interneti: [www.sozialministerium-bw.de](http://www.sozialministerium-bw.de)

Stuttgart, qershor 2016

Fotografia:

© Daniel Schreiber/Shotshop.com

# Informata

## mbi procedurën e përjashtimit nga banesa në rastet e dhunës shtëpiake

### PËRMBAJTJA

Hyrje.....	2
Procedura e përjashtimit nga banesa në rastet e dhunës shtëpiake.....	3
Këshilla dhe përgjigje në pyetje të shpeshta.	
• mbi përjashtimin policor nga banesa .....	3
• mbi Këshillimin .....	4
• Mbi mbrojtjen ligjore civile.....	5
• Mbi procedurën penale .....	7
Baza ligjore .....	8

# Hyrje

Viktimave të dhunës shtëpiake u duhet mbrojtje e posaçme: Sepse dhuna në ambientin shtëpiak nuk është çështje private. Dhe ajo asnjëherë nuk mund të arsyetohet me alkool, tronditje ose provokim. Përgjegjësia për dhunën qëndron gjithmonë te ai person, i cili e ushtron atë. Kush është i prekur nga dhuna, ka të drejtë në mbrojtje dhe ndihmë.

Termi "Dhunë shtëpiake" i përfshinë të gjitha trajtat e dhunës trupore, seksuale dhe shpirtërore (mes tjerash edhe shoqërore dhe ekonomike), e cila ndodh ndërmjet njerëzve të rritur, të cilët qëndrojnë ose kanë qëndruar në një marrëdhënie të ngushtë me njëri-tjetrin, pavarësisht nga vendi i kundërvajtjes. Këta janë para së gjithash persona në bashkëjetesë, mirëpo edhe në raporte tjera farefisnore.



Viktima janë kryesisht gratë. Rreth 25 përqind të grave në moshën 16 deri 85 vjeçare kanë përjetuar dhunë trupore ose seksuale - ose të dyat - nga partneri i tyre së paku njëherë ose edhe shumë herë.

Është detyrë e politikës të garantojë mbrojtje dhe mbështetje. Dhe Qeveria Republikane këtë detyrë e merr seriozisht. Prandaj, në vitin 2014 e kemi vendosur planin republikan të veprimit kundër dhunës ndaj grave. Me këtë, për herë të parë në Baden-Württemberg e kemi një koncept gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe për furnizimin e tyre sipas nevojave që kanë ato kur janë bërë viktima të dhunës shtëpiake, dhunës seksuale, martesës së dhunshme ose prostitucionit të dhunshëm.

Plani republikan për veprim, i cili është hartuar në një proces dyvjeçar bashkërisht me të gjitha institucionet e rëndësishme, tregon qartë që përjashtimi nga banesa është një masë e shpejtë dhe efektplote për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve të tyre. Nuk mund të pritet nga viktimat që të kujdesen vet për mbrojtjen e tyre dhe me këtë ta paguajnë edhe humbjen e banesës dhe ambientit të tyre të mirënjohur. Shteti, me përjashtimin nga banesa, u tregon kundërvajtësve një shenjë të qartë: Ndalo - Dhuna nuk është mjet për zgjidhjen e konfliktit!

Mbrojtja nga dhuna është e drejtë njerëzore, e cila vlen edhe në shtëpi. Kush nuk i njeh të drejtat e veta, as nuk mund t'i kërkojë ato. Kjo fletushkë do t'i informojë njerëzit, të cilët vuajnë nën dhunën shtëpiake, mbi gjendjen aktuale ligjore. Ajo jep përgjigje në pyetjet më të shpeshta, të cilat dalin në lidhje me përjashtimin nga banesa.



Manfred Lucha, Anëtar e Parlamentit Republikan  
Ministër për Çështje Sociale dhe për Integrim  
Baden-Württemberg

## Procedura e përjashtimit nga banesa në rastet e dhunës shtëpiake

Procedura e përjashtimit nga banesa përbëhet nga më shumë masa, të cilat në ndikim të ndërsjellë duhet të parandalojnë dhunën shtëpiake të mëtejme.

Masa e parë efektlote e përjashtimit nga banesa është përjashtimi policor nga banesa sipas § 27 a të Ligjit mbi Policinë. Policia - rëndomtë trupi i patrullës policore, i cili është thirrur të shkojë në vendin e ngjarjes - ia shpall kundërvajtësit një ndalesë shtëpiake të kufizuar, nëse ekziston rreziku që do të vijë sërish deri te kacafytjet e dhunshme dhe kur ndalesa shtëpiake është e përshtatshme për mënjanimin e këtij rreziku. Ju, si viktimë e dhunës, keni të drejtë të qëndroni në banesë.

Nëse ky rrezik mbetet edhe pas largimit nga banesa, policia mund t'ia ndalojë personit të përjashtuar të kthehet në banesë ose në zonën që kufizohet drejtpërdrejt me banesën (ndalimi i kthimit) dhe t'i afrohet personit të lënduar ose të kërcënuar (ndalimi i afrimit).

Masat policore parimisht kanë vetëm kohëzgjatje të kufizuar. Një mbrojtje me kohëzgjatje më të madhe ofrojnë vetëm masat mbrojtëse të shpallura në bazë të ligjeve civile. Për këtë gjë mund t'i drejtoheni gjykatës suaj themelore dhe të kërkoni shpalljen e masave të menjëhershme për tu caktuar banesën vetëm juve dhe/ose për t'ia ndaluar kundërvajtësit që tu afrohet gjegjësisht të kontaktojë me ju.

Pjesë tjera përbërëse të procedurës për përjashtim nga banesa janë

- këshillimi i personit të prekur,
- ndjekja e qëndrueshme penale.

Sa më mirë të jenë të përputhura masat me njëra tjetrën, aq më parë mund të çojë procedura për përjashtim nga banesa deri ta përfundimi afatgjatë i dhunës së drejtuar kundër Juve.

Në shumë raste të dhunës shtëpiake mund të ndërmerren vetëm masa të veçanta, dhe atë për arsye të ndryshme. Kështu, për shembull, mund të kërkohen vetëm masa mbrojtëse sipas të drejtës civile, pavarësisht nga ajo se është shpallur ndonjë përjashtim policor nga banesa apo jo. Edhe ofertat këshilluese qëndrojnë në dispozicion, pavarësisht nga ndonjë përjashtim policor nga banesa.

## Këshilla dhe përgjigje në pyetje të shpeshta.

### • *mbi përjashtimin policor nga banesa*

#### ÇKA DO TË THOTË PËRJASHTIMI NGA BANESA?

Përjashtimi nga banesa do të thotë që kundërvajtësi duhet të largohet nga banesa. Ju mund të mbeteni në banesë. Kundërvajtësi, rëndomtë, duhet t'i dorëzojë çelësat e shtëpisë. Derisa të vlen përjashtimi nga banesa, ai nuk guxon të kthehet.

#### SA ZGJATË PËRJASHTIMI NGA BANESA?

Enti për Rendin Publik vendos në lidhje me kohëzgjatjen e përjashtimit nga banesa varësisht nga shkalla e rrezikimit në rastin në fjalë. Në shumicën e rasteve, përjashtimi nga banesa zgjatë ndërmjet 4 dhe 14 ditë.

### **A MUND TË VAZHDOHET PËRJASHTIMI NGA BANESA?**

Po. Vendimi mbi një përjashtim të parë afatshkurtër nga banesa - bie fjala vetëm gjatë fundjavës - silllet rëndomtë nga trupi i patrullës policore në vendin e ngjarjes. Mbi kohëzgjatjen e mëtejme (deri në dy javë) vendos Enti për Rendin Publik i komunës gjegjësisht qytetit.

Një vazhdim i mëtejme nëpërmjet Entit për Rendin Publik të komunës rsp. qytetit (më së shumti për dy javë tjera) është vetëm atëherë i mundshëm nëse keni kërkuar masa mbrojtëse sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna.

### **ÇKA DUHET TË BËJË UNË NËSE KTHEHET KUNDËRVAJTËSI?**

Në këtë rast duhet menjëherë ta thirrni policinë. Nëse kundërvajtësi e shkel vendimin për përjashtim nga banesa, atëherë policia në rast nevojë mund ta mbyllë atë në ruajtje.

### **ÇKA DUHET TË BËJË KUR KAM FRIKË NGA KUNDËRVAJTËSI EDHE PSE ËSHTË PËRJASHTUAR NGA BANESA?**

Atëherë duhet të flisni me policinë dhe me zyrën për këshillime mbi frikën tuaj. Nëse edhe pas përjashtimit nga banesa nuk e ndieni vetën të mbrojtur sa duhet, atëherë mund të banoni përkohësisht në një shtëpi për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve.

### **A MUND TA KËRKOJ PEZULLIMIN E PËRJASHTIMIT NGA BANESA?**

Jo. Përjashtimi nga banesa nuk është i varur nga kërkesa Juaj. Policia e pezullon përjashtimin nga banesa vetëm atëherë kur është e mendimit që nuk ekziston më ndonjë rrezik. Mendimi Juaj është natyrisht i rëndësishëm kur duhet të vlerësohet se a mund të priten konflikte tjera të dhunshme. Mirëpo, sipas rastit, policia mund ta vlerësojë situatën ndryshe nga Ju.

### **A MUND TË VENDOSËT EDHE PËRJASHTIMI I PËRHERSHËM NGA BANESA?**

Jo. Masat policore parimisht kanë vetëm kohëzgjatje të kufizuar. Për urdhërimin e masave mbrojtëse afatgjate është kompetente gjykata civile.

## **• mbi Këshillimin**

### **KU MUND TË MARR KËSHILLA DHE PËRKRAHJE?**

Ka shumë këshilltore, të cilat japin këshilla të mira në rastet e dhunës shtëpiake. Në disa rrethe qytetesh dhe krahinash janë themeluar këshilltore të posaçme vetëm për procedurën e përjashtimit nga banesa gjegjësisht për dhunën shtëpiake. Këshilltare dhe këshilltarë të kualifikuar, të cilët mund të hasni në mirëkuptim për situatën tuaj, gjeni te shërbimet e përgjithshme sociale dhe te këshilltoret e shoqatave ose të asociacioneve për mirëqenien sociale. Në shumë vende ka zyre me kompetencë të lartë për këshillimin e grave mbi temën e dhunës. Në librin telefonik gjeni numrat e telefonit dhe adresat e zyrave këshilluese në afërsinë tuaj. Përpos kësaj, aty e gjeni numrin e telefonit të shtëpisë më të afërt për mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve.

## **SI MUND TA GJEJ KËSHILLTOREN E PËRSHTATSHME PËR MUA?**

Më e rëndësishmja është që të krijoni një raport mirëbesimi me këshilltaren gjegjësisht këshilltarin tuaj. Në një bisedë personale duhet të sqarohet se cila këshilltore është më e përshtatshme për Ju. Për këtë qëllim, në shumë vende ka të ashtuquajtura zyre të para. Aty mund të merrni informata në lidhje me procedurën mbi përjashtimin nga banesa dhe këshilla se si mund të veproni më tutje. Nga aty mund të udhëzoheni në ndonjë këshilltore tjetër, nëse e dëshironi një gjë të tillë.

## **A MUND TË ÇOJË DEKLARATA IME DERI TE AJO QË MUA TË MË MERREN FËMIJËT?**

Jo. Kundërvajtësi është përgjegjës për dhunën e jo Ju!

## **ÇKA NDODH ME FËMIJËT?**

Për vajzat dhe për djemtë dhuna shtëpiake është ngarkesë. Prandaj, pas përjashtimit nga banesa, te Ju lajmërohet një bashkëpunëtorë ose bashkëpunëtor i Entit për Fëmijë dhe të Rinj për të diskutuar me Juve se cilat oferta për mbështetje janë të përshtatshme për fëmijën gjegjësisht fëmijët tuaj - për shembull biseda me një psikologë ose me një psikolog.

## **KUSH MË NDIHMON MUA PËR PROBLEMET FINANCIARE?**

Nëse pas përjashtimit nga banesa nuk dispononi me kurrfarë mjeteve financiare, atëherë mund t'i drejtoheni edhe Entit për Ndihmë Sociale.

## **KU MUND T'I SHËROJ LËNDIMET E MIA?**

Varësisht se sa janë të rënda lëndimet e pësuar, duhet të trajtoheni ose te mjeku juaj shtëpiak, nga ndonjë specialist ose në ndonjë spital. Kërkoni nga mjeku gjegjësisht mjekja t'iu lëshojë një vërtetim mjekësor. Këtë mund ta parashtroni para gjykatës si dëshmi.

## **• Mbi mbrojtjen ligjore civile**

### **KU MUND TË KËRKOJ MBROJTJE LIGJORE CIVILE?**

Te Gjykata familjare e cila e ka kompetencën territoriale për ju. Kërkesën mund ta dorëzoni me shkrim. Nëse dëshironi ta parashtroni kërkesën gojarisht, ai duhet të futet në protokoll ose nga zyra e kërkesave ligjore ose nga sekretaria e gjyqit.

### **ÇFARË MUND TË KËRKOJ?**

Sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna, ju para së gjithash mund të kërkonti dy gjëra:

1. Që banesa të ju jepet në përdorim vetëm juve.
2. Që kundërvajtësit t'i ndalohej që të kontaktojnë me ju ose që t'ju afrohet.

### **A ËSHTË E MUNDUR QË BANESA TË MË JEPET NË PËRDORIM VETËM MUA, EDHE NËSE NDAJ KUNDËRVAJTËSIT NUK ËSHTË SHQIPTUAR PËRJASHTIMI NGA BANESA?**

Po. Parakusht për dhënien e banesës në përdorim vetëm juve është që kundërvajtësi i cili banon me ju në një banesë të përbashkët, të ketë ushtruar dhunë ndaj jush. Në raste të caktuara mjafton edhe kërcënimi me dhunë.

### **A ËSHTË E MUNDUR QË BANESA TË MË JEPET NË PËRDORIM VETËM MUA, EDHE NËSE KUNDËRVAJTËSI ËSHTË PRONAR OSE QIRAMARRËS I BANESËS?**

Po.

### **PËR SA KOHË MUND TA PËRDORI VETËM UNË BANESËN?**

Nëse ju jeni pronare ose qiramarrëse e vetme e banesës, atëherë dhënia e banesës në përdorim mund të bëhet përgjithmonë. Nëse kundërvajtësi është pronar ose qiramarrës i vetëm i banesës, atëherë dhënia e banesës në përdorim mund të kufizohet në së shumti gjashtë muaj. Nëse brenda këtij afati nuk ia dilni të gjeni banesë tjetër, gjyqi mund ta vazhdojë këtë afat edhe për së shumti gjashtë muaj të tjerë. Nëse banesën e keni marrë në qira ju së bashku me kundërvajtësin, ose nëse banesa është në pronësinë tuaj të përbashkët, gjyqi përsëri do ta kufizojë afatin e dhënies së banesës në përdorim.

### **SI MUND TË DËSHMOJ QË KUNDËRVAJTËSI MË KA RRAHUR OSE MË KA KËRCËNUAR?**

Njoftojeni gjyqin nëse ndaj kundërvajtësit është shqiptuar përjashtimi nga banesa. Për të sjellë vendimin e vet, gjyqi mund t'a kërkojë dokumentacionin nga policia. Edhe vërtetimet e mjekut dhe fotografitë mund të ndihmojnë. Nëse keni dëshmitarë, emërojini.

### **A MUND TË PENGOJ QË KUNDËRVAJTËSI TË TAKOHET ME FËMIJËT?**

Parimisht, babai dhe nëna e kanë edhe të drejtën dhe detyrimin që të kontaktojnë me fëmijën. Nëse ekziston rreziku që ju dhe fëmijët të keqtrajtoheni, mund të kërkonit nga Gjykata familjare që të ndërmerren masa për parandalimin e dhunës. Këto masa mund të përfshijnë ndalesat për të kontaktuar ose për t'u afruar, por edhe kufizimin ose heqjen e së drejtës së përkujdesjes prindërore. Në raste të veçanta mund të shqiptohet edhe urdhëresa që kontaktet me fëmijën të zhvillohen nën mbikëqyrje, që do të thotë që vizitat zhvillohen në prani të një personi të besueshëm gjegjësisht të një nëpunëseje ose të një nëpunësi të Entit për Fëmijë dhe të Rinj.

### **A MUND TË MË MBROJË GJYQI EDHE PREJ SHQETËSIMEVE?**

Po. Gjykata familjare mund të shqiptojë urdhëresë për mbrojtje në rast shqetësimesh të tepruara. Shqetësim i tepruar është p.sh. përcjellja dhe vëzhgimi i vazhdueshëm, terrori telefonik ose terrori me e-mail, me SMS, etj.

### **A MË DUHET TË ANGAZHOJ AVOKATE OSE AVOKAT?**

Jo, përfaqësimi nga ana e avokatit nuk është i domosdoshëm. Sidoqoftë, është gjë e dobishme nëse këshilloheni me një avokate ose një avokat specialist i së drejtës familjare.



## **KUSH I MERR PËRSIPËR SHPENZIMET E AVOKATIT?**

Në gjendje të zorshme financiare, keni të drejtë të këshilloheni falas me avokatin. Në raste të veçanta keni të drejtë të kërkonti mbulimin e shpenzimeve gjyqësore. Zyra e kërkesave ligjore e Gjykatës themelore ose sekretaria e gjyqit mund t'ju japë më shumë informacione rreth kësaj teme.

## **ÇFARË NDODH NËSE KUNDËRVAJTËSI SHKEL NJË URDHËRESË GJYQËSORE CIVILE?**

Në këtë rast thirreni policinë. Sepse shkelja e urdhëresave gjyqësore civile paraqet veprë penale sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna.

## **SA KOHË ZGJAT DERISA GJYQI TË VENDOSË LIDHUR ME KËRKESËN TIME?**

Nëse ju duhet vendim i shpejtë, mund të paraqitni kërkesë për vendim të përshpejtuar. Në rast urgjent, urdhëresa e mbrojtjes në kuadër të procedurës së përshpejtuar mund të shqiptohet madje edhe brenda ditës.

### **• Mbi procedurën penale**

## **ÇFARË NDODH NË PROKURORI DHE NË GJYQ?**

Kur prokuroria të njoftohet për një aksion policor, ajo heton nëse ekziston dyshimi fillestar për veprë penale dhe nëse të dhënat e dyshimta dhe dëshmitë mjaftojnë për të ngritur akuzë para gjyqit. Nëse çështja del para gjyqit, gjyqi gjatë seancës së gjykimit duhet ta krijojë vetë përshtypjen lidhur me fajësinë e të pandehurit. Nëse gjyqi ju thërret të vini në seancë, atje do t'ju pyesin në rolin e dëshmitares lidhur me ato që keni vërejtur ju vetë.

## **A DUHET TË PARAQITEM PARA PROKURORISË GJEGJËSISHT PARA GJYQIT KUR TË MË ÇOJNË THIRRJE?**

Po.

## **A DUHET T'U PËRGJIGJEM PYETJEVE TË PROKURORISË GJEGJËSISHT TË GJYQIT?**

Parimisht, ju jeni e detyruar të flisni para prokurorisë dhe para gjyqit. Mirëpo nëse me kundërvajtësin jeni në lidhje farefisnore, apo nëse jeni e fejuar ose e martuar me të, ose nëse jetoni në partneritet të regjistruar me të, keni të drejtë ta refuzoni dëshminë gjegjësisht të heshtni. Në këtë rast ju jeni e detyruar të paraqiteni para prokurorisë ose para gjyqit nëse jua kanë dërguar thirrjen, por kur të shkoni atje, keni të drejtë të mos pranoni të flisni për veprën.

## **A MUND TA NDAL PROCEDURËN PENALE?**

Në të shumtën e rasteve jo. Sidoqoftë, në shumë procedura, pa dhënë dëshmi viktima, nuk ka boll dëshmi për ta dënuar të pandehurin. Nëse pastaj në një rast të këtillë e përdorni të drejtën tuaj për të heshtur, mund të ndodhë që procedura të pezullohet ose që i pandehuri të shpallet i pafajshëm.

## A DO TË DËNOHET KUNDËRVAJTËSI EDHE PA DHËNË UNË DËSHMI?

Nëse dëshmitë tjera janë të mjaftueshme, kundërvajtësi mund të dënohet edhe nëse ju nuk flisni si dëshmitare.

## A MUND TA ANGAZHOJ NJË AVOKATE OSE NJË AVOKAT?

Ju në çdo kohë keni të drejtë të ju këshillojë ose të ju përfaqësojë një avokat ose një avokate të cilën mund ta zgjidhni ju vetë sipas dëshirës. Mund të kërkonit edhe mbulimin e shpenzimeve gjyqësore.

## Baza ligjore

Përfshirimi nga banesa, ndalesa e kthimit dhe ndalesa e afrimit e kanë bazën e vet ligjore në § 27 të Ligjit mbi Policinë Baden-Württemberg në versionin e datës 13 janar 1992 (Gazeta zyrtare GBl. fq. 1, pastr. fq. 596, 1993 fq. 155), ndryshuar së fundi me ligjin e datës 29 korrik 2014 (Gazeta zyrtare GBl. fq. 378) në fuqi prej 13 gushtit 2014.

Dispozita e § 27 është shtuar me Ligjin për ndryshimin e Ligjit mbi Policinë të datës 18 nëntor 2008 (Gazeta zyrtare GBl. fq. 390) në fuqi prej 22 nëntorit 2008.

§27a Përfshirimi nga lokaliteti, ndalesa e qëndrimit, përfshirimi nga banesa, ndalesa e kthimit, ndalesa e afrimit

(1) Për ta zbrapsur një rrezik ose për ta larguar një pengesë, policia përkohësisht mund të përfshijë një person nga një lokalitet ose t'ia ndalojë atij përkohësisht të shkelë në një lokalitet (përfshirimi nga lokaliteti).

(2) Policia mund t'ia ndalojë një personi të shkelë ose të qëndrojë në një lokalitet të caktuar, në një zonë të caktuar brenda një komune ose në një pjesë të komunës, nëse faktet e arsyetojnë supozimin që ky person do të kryejë atje veprë penale ose do të ndihmojë në kryerjen e veprës penale (ndalesa e qëndrimit). Ndalesa e qëndrimit duhet të jetë e kufizuar për nga koha dhe hapësira për aq sa është e domosdoshme për ta parandaluar veprën penale, ndërsa kufizimi hapësinor nuk guxon të përfshijë banesën e personit në fjalë. Ndalesa nuk guxon të zgjasë më shumë se tre muaj.

(3) Policia mund ta përfshijë një person nga banesa e tij dhe nga zona përreth saj, nëse ky përfshirje është i domosdoshëm për të mbrojtur një banor ose një banor tjetër të kësaj banese (person i lënduar ose i kërcënuar) nga një rrezik i madh që kanoset të ndodhë së shpejti (përfshirimi nga banesa). Nëse faktet e arsyetojnë supozimin që rreziku i madh do të vazhdojë të kanoset edhe pas daljes nga banesa, policia personit të cilin e ka përfshijë nga banesa mund t'ia ndalojë të kthehet në banesë ose në zonën përreth saj (ndalesa e kthimit) dhe t'i afrohet personit të lënduar ose të kërcënuar (ndalesa e afrimit).

(4) Nëse masat nga paragrafi 3 shqiptohen nga ana e shërbimit policor përmbartës, ato duhet të kufizohen në së shumti katër ditë pune, ndërsa nëse ato shqiptohen nga policia e administratës lokale, në së shumti dy javë. Nëse personi i lënduar ose i kërcënuar para skadimit të afatit kërkon masa mbrojtëse në përputhje me Ligjin për mbrojtje nga dhuna, policia e administratës lokale mund ta

zgjaset afatin edhe për së shumti dy javë të tjera, nëse ende janë të plotësuara kushtet nga paragrafi 3 fjalë 2 dhe nëse kjo gjë duket e domosdoshme duke mos e lënë pas dore interesin legjitim të personit të përjashtuar nga banesa. Masat mbarojnë ditën e hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor, të marrëveshjes para gjyqit ose të urdhëresës së përkohshme.

(5) Për kërkesat në bazë të Ligjit për mbrojtje nga dhuna si dhe për vendimet e marra në bazë të këtyre kërkesave, për marrëveshjet para gjyqit ose për urdhëresat e përkohshme, e në veçanti për masat e urdhëruara, për kohëzgjatjen e masave dhe shkeljen e detyrimeve të urdhëruara, gjyqi e njofton menjëherë policinë përgjegjëse të administratës lokale dhe shërbimin përgjegjës të policisë.

## Shënim:

Fletushka informative e Ministrisë së Drejtësisë Baden-Württemberg me titull "Të fortë kundër dhunës shtëpiake" ["Stark gegen häusliche Gewalt"] në lidhje me Ligjin për mbrojtje nga dhuna, mund të porositet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë Baden-Württemberg, Schillerplatz 4, 70173 Stuttgart, telefoni 0711 / 279-0, e gjithashtu edhe të merret nga faqja në Internet e Ministrisë së Drejtësisë në adresën [www.jum.baden-wuerttemberg.de](http://www.jum.baden-wuerttemberg.de).